



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0385

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Triangle” sh.p.k., me seli në Suharekë, kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtim i objekteve kulturore, rinore dhe sportive pjesa e dytë, rregullimi i hapësirave të jashtme në qendrën sportive Sezair Surroj” me numër të prokurimit 622-23-2939-5-2-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me datë 09/08/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Triangle” SH.P.K. me nr. 2023/0385, e datës 12/06/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal i Prizrenit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtim i objekteve kulturore, rinore dhe sportive pjesa e dytë, rregullimi i hapësirave të jashtme në qendrën sportive Sezair Surroj”, me numër të prokurimit 622-23-2939-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Triangle” SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 29.03.2023, Kuvendi Komunal i Prizrenit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Me datën 05.04.2023, AK ka publikuar formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara, ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 18.04.2023.

Me datë 23.05.2023, AK ka publikuar B58 Njoftimin Mbi Vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Ndërtim i objekteve kulturore, rinore dhe sportive pjesa e dytë,

rregullimi i hapësirave të jashtme në qendrën sportive Sezair Surroj”, me numër të prokurimit 622-23-2939-5-2-1, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik GOE; Fatmir Godeni B.I & EBK SH.P.K.

Me datë 29.05.2023, Operatori Ekonomik “Triangle” sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Kuvendi Komunal i Prizrenit, dhe me datë 01.06.2023, Autoriteti Kontraktues, Kuvendi Komunal i Prizrenit, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 23.05.2023.

Me datën 12.06.2023, Operatori Ekonomik “Triangle” sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 0385/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 160 000.00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Palët janë njoftuar palët me raportin e ekspertizës me datë: 29 qershorë 2023, AK, Kuvendi Komunal i Prizrenit nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE “Triangle” sh.p.k, me datë 30.06.2023 ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 29.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “Triangle” sh.p.k, të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 23.05.2023, dhe lënda të kthehet në rivlerësim (njoftimi për dhënie të kontratës).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashitësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Triangle” sh.p.k.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Pretendimi i OE ankues që AK nuk ka mundur të eliminoj OE ankues për faktin se është në kundërshtim me Rregulloren Nr.001_2022,dhe rregullorja e cila është thirrur AK është e shfuqizuar, Eksperti Shqyrtues sqaron se kushtet për cilësimin e ofertës si jo normalisht e ulët konform nenit 41.3 të Rregullores Nr.001_2022 nuk janë plotësuar për shkak se nuk kemi tre oferta, mirëpo kjo nuk e kufizon AK që të vlerësoj besueshmërinë e tenderëve dhe rrjedhimisht të kërkoj shpjegime në përputhje me paragrafët e nenit 61 të LPP-së, si dhe nenet 41.4 dhe 41.5 të Rregullores nr.001_2022.

Eksperti Shqyrtues thekson se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është rreth 10 000.00 Euro më e shtrenjtë se sa oferta e OE ankues, që nënkupton se si ofertë e përgjithshme nuk paraqet ndonjë dallim shume te madh në raport me disa pozicione të cilat AK i ka cilësuar si jo normalisht të ulëta. Andaj eksperti shqyrtues duke u mbështetur në konceptin e tenderit jo normalisht i ulët i cili i parkete Autoriteti Kontraktues, thekson se e rëndësishme është të respektohet dispozita e Nenit 61 të LPP-së si dhe Rregullorja nr.001_2022 për tenderët jo normalisht të ulët, ku në bazë të këtyre dispozitave, ndalohet refuzimi automatik i ofertave pa përdorur një procedurë inter partes, dhe këtë hap AK e ka ndjekur dhe arsyetimet e OE ankues nuk kanë qenë bindëse për AK dhe ka vepruar konform paragrafit 4 dhe 5 të Nenit 61 Të LPP-së. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Lidhur me pretendimin e OE ankues, Eksperti Shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Inxhinier i diplomuar imakinerisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i makinerisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit”, Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “CV-a, Diploma e noterizuar, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt si dhe Vendimi për caktimin e menaxherit”,

Për inxhinier të makinerisë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar z. Suad Zekovci, për të cilin janë ofruar dëshmitë si në vijim: Diplomë, kontratë punë, CV-ja. Eksperti shqyrtues sqaron se ka mospërputhje në mes të diplomës së inxhinierit dhe noterizimit për shkak se në diplomë është specifikuar Grada e kualifikimit inxhinier i makinerisë ndërsa në noterizim shkruan fakulteti i mjekësisë, gjithashtu në bazë të CV nuk mund të verifikohet përvoja e tij e punës për shkak se data e periudhës së punës ku i njëjti ka mbikqyrë projekte figuron si: 2014- dhe 2017, dhe nuk ka të pasqyruar periudhën e plotë kohore.

Gjithashtu, në lidhje me kontratën e punës për të cilën OE ankues pretendon se është fiktive, eksperti shqyrtues sqaron se për inxhinierin e makinerisë është ofruar kontrata e punës e cila është e nënshruar nga punëmarrësi dhe e nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi, ndaj dhe palët janë përgjegjës dhe bartin obligime vetë për kushtet e themelimit të marrëdhënies së punës, ku në rast të mosmarrëveshjes palët kanë paraparë organin për zgjidhjen e atyre mosmarrëveshjeve që në kontratë është përcaktuar Gjykata Komunale Prishtinë.

Andaj eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit, AK të kërkoj sqarime dhe të verifikoj noterizimin e diplomës për inxhinierin e makinerisë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues i cili thotë se GOE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm pasi nuk ka autorizim të vlefshëm nga prodhuesi ku autorizimi i dilerit është i skaduar pasi që vetë AK në NJK dhe në DT e ka kërkuar.

Eksperti Shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Operatori Ekonomik duhet të ofroj AUTORIZIM nga prodhuesi ose dileri i autorizuar lidhur me autenticitetin dhe cilësinë e produkteve”.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar i nënshkruar, i vulosur dhe i noterizuar lidhur me autenticitetin dhe cilësinë e produkteve”.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatën e shitësit të autorizuar (Autorizim i Prodhuesit) e cila është me afat nga dt. 01.04.2022-01.04.2023, dhe ky operator ekonomik ka ofertuar me dokument i cili është i skaduar, dhe lidhur me këtë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që i njëjti ka bërë kërkesë për tu pajisur me dokument të ri me validitet dhe as AK nuk ka kërkuar sqarime nga i njëjti. Edhe pse kërkesë decidive e dosjes nuk ka qenë që Autorizimi nga prodhuesi të jetë me vlefshmëri, mirëpo kjo nënkupton që duhet të jetë për faktin se determinon edhe certifikatat ISO tjera të kërkuara në këtë AP, për shkak se kjo kompani autorizohet ti përdor edhe certifikatat ISO, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4

Eksperti Shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor në lidhje me mungesën e certifikatave të përshtatshmërisë EN 1177 për cilësinë e dyshemesë së gomës nuk e ka ofruar certifikatën adekuate sipas kërkesës së dosjes së tenderit, OE i propozuar për kontratë ka ofruar certifikatën 1176-1, po ashtu në lidhje me certifikatën EN ISO 12944, në dokumentet e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është gjendur ndonjë dëshmi që ky OE ka në posedim certifikatës EN ISO 12944 për gyp të çelikut, andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5

Në lidhje me pretendimin se GOE i propozuar për kontratë nuk ka garancion për pajisjet, eksperti shqyrtues sqaron se Garancioni për produktet e ofruar është kërkesë e dosjes së tenderit, ndërsa në dokumentat e ofruar në E prokurim nga OE i rekomanduar për kontratë nuk gjendet dokumenti (garancioni i nënshkruar dhe i vulosur), andaj GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar këtë kërkesë të DT-së, rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 6

OE ankues thekson se GOE është i pa përgjegjshëm pasi dokumentet për pajisjet e tyre DUD-at për cilindra janë të pa lexueshëm. Eksperti Shqyrtues sqaron se kërkesë e DT-ja është 2 Rul për ngjeshje (Cilindër), ku GOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 2 dëshmi (DUD Doganor), të cilan në pamje të parë ngjajnë të njëjta, mirëpo në këto dëshmi nga përkrahimi i pajisjes kuptohet që Marka e pajisjes është e njëjtë, Tipi i pajisjes është i njëjtë, Viti i prodhimit të pajisjes është i njëjtë, ndërsa Numri serik i pajisjes janë të ndryshëm si dhe ngjyra e pajisjes është e ndryshme andaj meqë Numrat serik të pajisjes janë të ndryshëm, mirëpo dokumentet janë shumë të njëjta me aq sa shifet në këto dëshmi, eksperti rekomandon që AK në rivlerësim të AP të bëjë verifikimin e plot të pajisjes.

Ndërsa në lidhje me faturën ndërmjet Badallaj dhe Vëllezërit e Bashkuar për pajisjen ngarkues nuk ka transaksion bankar, ndërsa në DUD doganor pronar i ngarkuesit është “NPT DITA”, Lidhur me këtë çështje ekspertit shqyrtues sqaron se për plotësimin e kërkesës së dosjes për ngarkues nga ana e OE të propozuar për kontratë është ofruar pajisja ngarkues me lopat, kjo pajisje është në pronësi të “NPT DITA”, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një faturë për këtë pajisje e cila është ndërmjet Badallaj dhe vëllezërit e bashkuar, andaj ekspertit shqyrtues, sqaron se ka mospërputhje në mes të faturës dhe pronësisë së pajisjes, dhe rekomandon që në rivlerësim AK të bëjë verifikimin e pajisjes.

Përgjigje në pretendimin ankimor 7

Në lidhje me pretendimin ankimor ku OE ankues thekson se AK pa përdorur standard të dyfishtë, ku ka diskriminuar OE për shkuan se njërit i ka kërku sqarime dhe tjetrit jo. Eksperti Shqyrtues, sqaron se OE ankues ka ngritur tre pozicione si çmime që AK është dashur të kërkoj sqarime, pasi që koncepti i tenderëve jo normalisht i ulët i përket AK-së, mirëpo Eksperti Shqyrtues, e konsideron si të bazuar pretendimin e OE ankues për faktin se AK është dashur ti konsideroj OE pjesmarrës të barabartë dhe te veproj konform nenit 7 të LPP-së dhe të veproj në përputhje me Nenin 61 të LPP-së dhe Nenin 41 të Rregullores nr. 001-2022.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e

ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

PSH konsideron se AK nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore, konkretisht nenin 59 të LPP, ngase konform kriterëve kualifikuese të vendosura në DT/NJK, mjafton që për këtë lëndë PSH të ndalet vetëm tek dy pretendimet ankimore që janë përcaktuese në vendimarrjen meritore, e që kanë të bëjnë me atë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatën e shitësit të autorizuar (Autorizim i Prodhuesit) e cila është me afat nga dt. 01.04.2022-01.04.2023, dhe ky operator ekonomik ka ofertuar me dokument i cili është i skaduar, dhe lidhur me këtë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që i njëjti ka bërë kërkesë për tu pajisur me dokument të ri me validitet si dhe OE të rekomanduar i mungojnë certifikatat të përshtatshmërisë EN 1177 për cilësinë e dyshemesë së gomës nuk e ka ofruar certifikatën adekuate sipas kërkesës së dosjes së tenderit, OE i propozuar për kontratë ka ofruar certifikatën 1176-1, po ashtu në lidhje me certifikatën EN ISO 12944, në dokumentet e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është gjendur ndonjë dëshmi që ky OE ka në posedim certifikatës EN ISO 12944 për gyp të çelikut. Andaj, këto bëjnë që operatori ekonomik i cili është rekomanduar për kontratë të jetë i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Ndërsa, sa i përket eliminimit të OE ankues, PSH sqaron se oferta e OE ankues në dukje nuk është ofertë jo-normalisht e ulët dhe si ofertë e përgjithshme nuk paraqet ndonjë dallim shume të madh në raport me disa pozicione të cilat AK i ka cilësuar si jo normalisht të ulëta. megjithatë PSH evidenton se Autoriteti Kontraktues, ka vë në zbatim dispozitat e Nenit 61 të LPP-së si dhe Rregullorja nr.001_2022 për tenderët jo normalisht të ulët, ku në bazë të këtyre dispozitave, ndalohet refuzimi automatik i ofertave pa përdorur një procedurë inter partes, dhe këtë hap AK e ka ndjekur dhe ka eliminuar OE ankues sepse sqarimet e OE ankues nuk kanë qenë bindëse për AK. PSH konstaton se AK ka qenë deshtë ta jep një arsyetim/përgjigje në sqarimet e ofruar nga OE, (sepse as në kërkesën për sqarime të pozicioneve AK nuk ka qenë mjaftë i qartë se për çka konkretisht këto pozicione kanë çmime jo normalisht të ulët). Andaj, obligohet AK që në fazën e ri-vlerësimit të jap arsyetimet se cilat janë shkaqet që këto sqarime janë apo nuk janë bindëse për AK dhe të argumentuara, po të kishte ndodhur me kohë, ndoshta as OE nuk do të kishte ardhur me ankesë në OSHP. Po ashtu, do të ishte më e lehtë edhe për ekspertin shqyrtues por edhe për Panelin Shqyrtues ta marrin një vendim meritore lidhur me këtë çështje.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenet 7, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në

mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - "TRIANGLE" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: